



Republika e Kosovës



Komuna e Vushtrrisë

10 Nr. 206 /17

Datë: 06.03.2017

Mbështetur ne Neni 5. Pika c, të Ligjit nr. 03/L – 068 për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, nenit 2 , pika 1, Udhëzimit Administrativ të MASHT-it Nr.17/2009, Udhëzimit Administrativ të MASHT-it Nr.06/2015 Drejtoria Komunale e Arsimit në Vushtrri shpallë:

KONKURS

Për vendet e lira të punës

- **Një Mësimdhënës i Gjeografisë me kohë të caktuar në Gjimnazin “Eqrem Çabej”Vushtrri, (deri me 30.06.2017).**
- **Dy Punëtor teknik-pastrues në SHF”Ali Kelmendi”Vushtrri.**

Kushtet për mësimdhënës :

Për këtë vend të punës kërkohet kualifikimi përkatës profesional, sipas UA – 06/2015 (Për normativ mbi kuadrin profesional të arsimit).

Aplikacionet merren në zyrën e arkivit komunal. Aplikacionit i bashkëngjiten dokumentet: Fotokopje të vërtetuara te noteri për kualifikim përkatës, diploma, certifikata e diplomimit jo më e vjetër se gjashtë muaj, ekstrakti i lindjes, vërtetimi për përvojën e punës në arsim – mësimdhënie certifikaten, që nuk është nën hetime dhe certifikatat e trajnimeve. Dokumentet e dorëzuara nuk kthehen. Konkursi mbetet i hapur 15 ditë prej ditës së shpalljes në shtyp.

Intervistimi i kandidatëve do të mbahet me datën 22.03.2017 në ora 13:30 në sallën e Kuvendit Komunal.

Kushtet për punëtorë teknik - pastrues:

Kandidatët e interesuar për të konkurruar për vendin e punës punëtor teknik-pastrues , duhet t'i plotësojnë këto kushte:

Letërnjoftimin e Republikës së Kosovës

Ekstraktin e lindjes.

Diplomën e shkollës fillore, preferohet shkolla e mesme .

Detyrat e punës për punëtor teknik-pastrues, do të caktohen me kontratë të punës.

Aplikacionet merren në zyrën e arkivit komunal. Aplikacionit i bashkëngjiten dokumentet: Letërnjoftimi, ekstrakti i lindjes, Diploma fotokopje e vërtetuara te noteri, përvoja e punës nëse ka. Dokumentet e pa kompletuara nuk merren në shqyrtim.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë prej ditës së shpalljes në shtyp. Intervistimi i kandidatëve do të mbahet me datën 22.03.2017 në ora 13:30 në sallën e Kuvendit Komunal.

Musaj Tërbunja
Drejtore i DKA-së